



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 5-9/2021 regjistri (JD)
Datë. 03.10.2022

Nr. 5 i vendimit
Datë 03.10.2022

VENDIM
I KOLEGJIT TË SHQYRTIMIT PARAPRAK

Kolegji i Shqyrtimit Paraparak, i përbërë nga gjyqtarët:

Sokol Çomo	Gjyqtar
Albana Shtylla	Gjyqtare
Ina Rama	Gjyqtare

– mori në shqyrtim paraparak në dhomë këshillimi mbi bazë aktesh, më datë 03.10.2022, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, çështjen e Juridiksionit Disiplinor (JD) nr. 5-9/2021, datë 03.10.2022, që i përket:

KËRKUES: Hasan Roqi.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Anëtarët e Gjykatës Kushtetuese:
Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Altin Binaj, Përparim Kalo, Sonila Bejtja, Elsa Toska.

OBJEKTI:

1. Saktësimi i të metave të vendimit nr. 2, datë 24 janar 2022, të Gjykatës Kushtetuese, Kolegji i Posaçëm i Apelimit.
2. Plotësimi i vendimit nr. 2, datë 24 janar 2022, të Gjykatës Kushtetuese, Kolegji i Posaçëm i Apelimit.
3. Sqarimi dhe interpretimi i vendimit nr. 2, datë 24 janar 2022, të Gjykatës Kushtetuese, Kolegji i Posaçëm i Apelimit.
4. Kthimi nga Gjykata Kushtetuese në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit i vendimit nr. 2, datë 24 janar 2022, për shkak të detyrueshmërisë së respektimit të kompetencës dhe juridiksionit në çështjen e Juridiksionit Disiplinor nr. 9, datë 19 tetor 2021, të diktuar nga dispozita e nenit 86, pika 1 e ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës

Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të pamarrë në konsideratë nga Kolegji i Posaçëm i Apelit.

BAZA LIGJORE:

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë: neni 15; neni 17, pikat 1 dhe 2; neni 18, pikat 1, 2 dhe 3; neni 25; neni 37; neni 41, pikat 1 dhe 2; neni 44; neni 122, pikat 1, 2 dhe 3; neni 126; neni 128, pika 1, pika 2, shkronja “a”, pika 3, shkronja “c”; neni 131, pika 1, shkronja “f”; neni 132, pikat 1 dhe 2; neni 134, pika 1, shkronja “i”; neni 137; neni 179, pika 7.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut: nenet 3; 6.1; 8.1; 13; 14; 41; Protokolli 1, neni 1; Protokolli 16, neni 1.

Ligji nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar: neni 1, pikat 1 dhe 2; neni 10, pikat 6, 9 dhe 13; neni 10/a; neni 10/b, pika 1, shkronjat “b”, “ç” dhe “d”; neni 10/c, pika a; neni 10/ç, pika 3; neni 16; neni 25, pika 1; neni 26, pikat 1, 2 dhe 3 (për vendimin 76/2000 të Gjykatës Kushtetuese); neni 31/c, pikat 1 (fjalja e fundit) dhe 2; neni 34, shkronja “a”; neni 38, pika 6; neni 42, pikat 1, 2 dhe 3; neni 44/b, pikat 1 dhe 2; neni 45, pikat 1 dhe 2; neni 48, pika 1; neni 49, pika 3, shkronja “e”, pika 4; neni 50, pika 4; neni 51, pika 1, shkronjat “a” dhe “b”; neni 54, pikat 1, 2, 3 dhe 4; neni 55; neni 71, pikat 1, 2 dhe 3; 71/a, pika 1, shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç”; neni 71/b, pikat 1, 2, 3 dhe 4; neni 71/ç, pikat 1, 2, 3 dhe 4; neni 72, pika 7; neni 76, pikat 1, 2 dhe 3; neni 80, pika 1; 81, pikat 1, 2, 3 dhe 4; neni 86, pika 1.

Kodi i Procedurës Civile: nenet 312, 313, 314 dhe 451/a.

Kodi Civil: nenet 608, 609, 610, 625 dhe 640.

Kolegji i shqyrtimit paraprak të kërkesës, pasi dëgjoi gjyqtarin relator Sokol Çomo, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim “Kolegji”) është administruar kërkesa e paraqitur nga z. Hasan Roqi me nr. 65/10 prot., datë 03.02.2022, me objekt dhe bazë ligjore si ajo e përcaktuar në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

2. Kolegji i Shqyrtimit Paraparak, në vendimin nr. 2, datë 24.01.2022, që i përket çështjes së juridiksionit disiplinor (JD) nr. 9/2021, datë 19.10.2021, ka çmuar se të gjitha kërkimet e paraqitura nga kërkuesi nuk janë në kompetencën dhe juridiksionin e Kolegjit dhe, bazuar në nenet 31 dhe 31/a, pika 2, germat “a” dhe “b” të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (në vijim “ligji nr. 8577, datë 10.02.2000”) ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare dhe përcjelljen e kërkesës së kërkuesit Hasan Roqi Gjykatës Kushtetuese.
3. Me kërkesën nr. {***} prot., datë 03.02.2022, z. Hasan Roqi ka kërkuar, ndër të tjera, *saktësimin, plotësimin, sqarimin dhe interpretimin e vendimit nr. 2, datë 24.01.2022, të Kolegjit, si dhe kthimin nga Gjykata Kushtetuese në Kolegj të vendimit nr. 2, datë 24 janar 2022.*

II. Vlerësimi i kërkesës nga Kolegji i Shqyrtimit Paraparak

4. Kolegji vlerëson se pas shpalljes së vendimit nr. 2, datë 24.01.2022, të Kolegjit të Shqyrtimit Paraparak, ky vendim nuk mund të anulohet ose të ndryshohet, por në mënyrë përjashtimore, ai mund të saktësohet ose plotësohet kur ekzistojnë shkaqet e parashikuara në nenin 80 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar. Në këto kushte, në këtë vendim do të trajtohen vetëm kërkimet e kërkuesit për saktësimin dhe plotësimin e vendimit nr. 2, datë 24.01.2022 dhe nuk do të trajtohen kërkimet që kanë të bëjnë me anulimin ose ndryshimin e vendimit të sipërcituar.
5. *Lidhur me pretendimin e kërkuesit se në vendimin nr. 2, datë 24 janar 2022, të KPA-së, në faqen 2, gjykata nuk ka vendosur të plotë bazën ligjore të kërkesës, Kolegji vlerëson se pretendimet e kërkuesit për mospasqyrimin e plotë të bazës ligjore sipas kërkesës së paraqitur prej tij, janë të pabazuara. Në vendimin nr. 2, datë 24.01.2022, të Kolegjit, janë pasqyruar në mënyrë të plotë të gjitha kërkimet e kërkuesit në objektin e kërkesës. Për sa i përket bazës ligjore, Kolegji është fokusuar dhe ka referuar parashikimet ligjore që kanë lidhje me shqyrtimin e kërkesës brenda juridiksionit të tij, pasi mënyra e zbatimit të ligjit nga Kolegji, nuk është e lidhur me bazën ligjore që kërkuesi ka vendosur në kërkesë. Si në ligjin nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, ashtu dhe në Kodin e Procedurës Civile, nuk ka asnjë parashikim ligjor që e detyron gjykatën që në pjesën hyrëse të vendimit të saj, të tregojë bazën ligjore të përcaktuar nga kërkuesi, si një element të detyrueshëm të vendimit. Në këto kushte, nuk rezulton që Kolegji të ketë bërë ndonjë gabim në shkrimin e vendimit.*
6. *Lidhur me pretendimin e kërkuesit se në rubrikën I, “Rrethanat e çështjes”, gjykata ka vendosur në mënyrë të gabuar fjalinë e parë, të cilën duhet ta heqë dhe ta zëvendësojë me fjalinë e duhur dhe të drejtë të dhënë nga kërkuesi në objektin e parë (nr. 1) të kërkesës para Gjykatës Kushtetuese, datë 25 mars 2021, si vijon: “Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i mospranimit të rekursit ndaj vendimit nr. 191, datë 29.04.2020, të SPAK-ut,*

vendimit nr. 208, datë 12.06.2020, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, vendimit nr. 157, datë 10.09.2020, të Gjykatës së Posaçme të Apelit Kundër Korrupsionit dhe Krimit të organizuar; vendimit nr. 204, datë 27.11.2020, të Gjykatës së Posaçme të Apelit Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar”, Kolegji vlerëson se në rubrikën I, “Rrethanat e çështjes”, në faqet 2 dhe 3 të vendimit nr. 2, datë 24.01.2022, të Kolegjit, është cituar i plotë objekti i kërkesës së kërkuesit drejtuar Gjykatës Kushtetuese, sipas vendimit nr. 86, datë 22.06.2021, të Gjykatës Kushtetuese, në dhënien e të cilit kërkuesi pretendon se janë kryer shkelje disiplinore nga ana e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, si dhe për të cilin kërkon shpalljen si antikushtetues. Në këto kushte, nuk rezulton që nga ana e Kolegjit të jetë bërë ndonjë gabim në shkrimin e vendimit.

7. *Lidhur me pretendimin e kërkuesit se: Në rubrikën II, “Pretendimet e kërkuesit”, paragrafi 3, fjalia e parë është vendosur gabim nga gjykata dhe duhet rregulluar*, pasi kërkuesi nuk ka kërkuar shfuqizimin e disa vendimeve të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Gjykatave të Shkallës së Parë dhe të Apelit Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, por shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e RSh-së të mospranimit të rekursit ndaj vendimeve të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Gjykatave të Shkallës së Parë dhe të Apelit Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Kolegji vlerëson se në rubrikën II, “Pretendimet e kërkuesit”, paragrafi 3, faqja 3 e vendimit nr. 2, datë 24.01.2022, është cituar i plotë objekti i kërkesës së kërkuesit drejtuar Gjykatës Kushtetuese, sipas vendimit nr. 86, datë 22.06.2021, të Gjykatës Kushtetuese, në dhënien e të cilit kërkuesi pretendon se janë kryer shkelje disiplinore nga ana e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, si dhe për të cilin kërkon shpalljen si antikushtetues. Në këto kushte, nuk rezulton që nga ana e Kolegjit të jetë bërë ndonjë gabim në shkrimin e vendimit.
8. *Lidhur me pretendimin e kërkuesit se në rubrikën II, “Pretendimet e kërkuesit”, duhet të korrigjohet shprehja “e ndihmës juridike parësore”, e cila, sipas kërkesës së kërkuesit, është “ndihmë juridike dytësore”, e cila ndryshon nga ndihma juridike parësore*, Kolegji vëren se terminologjia e përdorur nga kërkuesi në kërkesë është “ndihmë juridike dytësore”, por pavarësisht kësaj, Kolegji vlerëson se ky është një element i parëndësishëm dhe nuk ka pasur asnjë efekt në marrjen dhe arsyetimin e vendimit të Kolegjit.
9. Në përfundim, Kolegji për Shqyrtimin Paraprak çmon se kërkesa e kërkuesit për saktësimin dhe plotësimin e vendimit nr. 2/2022, datë 24.01.2022, të Kolegjit, nuk u provua se bazohet në ekzistencën e ndonjë gabimi në shkrim ose ndonjë pasaktësie të dukshme, por kryesisht bazohet në pretendime dhe kërkime për të ndryshuar thelbin e vendimmarrjes së Kolegjit, në kundërshtim me nenet 75 dhe 76, pika 1, dhe 80 të ligjit nr. 8577/2000, për rrjedhojë ajo është e pabazuar në fakte dhe në ligj dhe, si e tillë, duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji për Shqyrtimin Paraprak, bazuar në nenet 31 dhe 80 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës së kërkuarit Hasan Roqi.

Tiranë, më 03.10. 2022

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi